

ExpressOnline

Lyp n'Expri



Teatër Film Libri Expo Muzikë TV ExpressBook

SHKARKO

ARKIVA

Ballina → Arte → Libri



Rihapet biblioteka austriake

Biblioteka austriake, e cila u rihap të premtën në objektin e Fakultetit Filologjik, do t'u shërbejë studentëve jo vetëm të mësojnë gjuhën gjermane, por edhe të përdorin literaturë të fushave të ndryshme në këtë gjuhë.

Nga Alfred Beka më 26.09.2009 në ora 14:51



Në objektin e Fakultetit Filologjik u rihap biblioteka austriake, me ç'rast të pranishëm ishin personalitete të ndryshme austriake dhe vendore. Duke i përshëndetur të pranishmit, Mujë Rugova, rektori i Universitetit të Prishtinës, e vlerësoi lartë rihapjen e kësaj biblioteke si dhe ndihmën e vazhdueshme që shteti austriak e ka dhënë për popullin e Kosovës, e në veçanti për arsimin e lartë në Kosovë.

"Kam kënaqësinë që në emër të Universitetit të Prishtinës të ju uroj mirëseardhje në këtë mbrëmje ku shteti mik i përhershëm, Austria, lëshon në punë një bibliotekë të veçantë për katedrën e gjermanistikës", u shpreh Rugova. Ai shtoi se nuk është hera e parë që shteti austriak për më shumë se një shekull mbështet popullin shqiptar.

"Si popull i këtij trualli do t'i jemi gjithmonë mirënjohës shtetit austriak dhe popullsisë së tij, e cila ndanë në vazhdimësi, nga buxheti i saj, ndihmën për Kosovën", vazhdoi rektori Rugova. Sipas tij, kjo bibliotekë është çerdhe ku të rinjtë tanë dhe pedagogët tanë do të mësojnë një gjuhë botërore, një gjuhë të shkencës dhe një gjuhë të teknikës, të cilat, siç u shpreh rektori, do të zbatohen këtu në Kosovë.

"Kjo bibliotekë do të iu bashkëngjitet veprave të mëdha të Austrisë, të cilat ajo në vazhdimësi i ngriti, është duke i ngritur dhe do t'i ngritë në këto troje dhe ne gjithmonë do t'i jemi falënderues për punën e madhe që e ka bërë dhe është duke e bërë", tha Rugova. Ai tregoi se kur ka qenë në Vjenë të Austrisë e ka vizituar muzeun ushtarak dhe aty e ka parë shpatën dhe përkrenaren e Skënderbeut dhe është befasuar.

Duke folur për shtetin dhe popullin e Austrisë, rektori Rugova tha se bëhet fjalë për një shtet dhe një popull që ka respektuar kulturën dhe historinë e popujve të tjerë. Në fund, Rugova tregoi se edhe vet objekti ku sot është rektorati është objekt që e ka ngritur Austria diku në vitin 1915 apo 1916.

Ndërkaq, Emil Brix, udhëheqës i Departamentit për Çështje Kulturore e Politike në Ministrinë Federale për Çështje Europiane dhe Ndërkombëtare, tha se i vjen mirë që shpata dhe përkrenarja e Skënderbeut ndodhen në Vjenë, por më shumë i vjen mirë që ato ndodhen në muze. Ai tregoi se biblioteka austriake po hapet në Prishtinë para disa qendrave të tjera, si për shembull në Podgoricë të Malit të Zi ku ende nuk është hapur. Brix, midis tjerash, premtoi bashkëpunim të mëtutjeshëm kulturor ndërmjet Kosovës dhe Austrisë.

Duke folur për Express, Johann Guenther, udhëheqës i Projektit për Bashkëpunim mes Kosovës dhe Austrisë në Fushën e Arsimit të Lartë, tha se kur ka ardhur në Kosovë para tri vjetëve gjithmonë e ka parë të rëndësishme që të ketë një shkëmbim kulturor mes Kosovës dhe Austrisë dhe tregoi se është munduar që të ndërtohet një bibliotekë reprezentative e Austrisë. "Dhe kjo është baza për këtë shkëmbim kulturor, kosovarët mund të marrin libra nga Austria, dhe ne do të sjellim artistë dhe shkrimtarë nga Austria në Kosovë, siç është rasti me Barbara Frischmuth. Ne deri më tani kemi tre mijë libra, mirëpo e kemi ndërtuar atë për dhjetë mijë libra dhe ky është edhe caku ynë", tha Guenther.

Ndërsa, shkrimtarja Barbara Frischmuth lexoi pjesë të ndryshme prej veprave të saj si dhe tregoi se ka bërë studime për Bektashinjtë. "Unë kam studiuar turqishten, më vonë edhe arabishten. Dikur kam menduar të mësoj edhe shqipen, sepse jam munduar të kuptoj më mirë botën e bektashinjeve", tha shkrimtarja austriake, e cila tregoi se më vonë, pas mësimit të gjithë atyre gjuhëve, nuk ia kishte marrë mendja që ta mësonte edhe shqipen.

Shpërndaje artikullin:



Komentet